REZOLUTAT E KËSHILLIT TË SIGURIMIT PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË

PHOTO: UN PHOTO / RYAN BROWN

1325 (2000)	1889 (2009)	1820 (2008)	1888 (2009)	1960 (2010)
Lidershipi i grave në krijimin e paqes dhe parandalimin e konfliktit		Parandalimi dhe reagimi ndaj dhunës seksuale të ndërlidhur me konflikt		

PËRSHKRIM

1325 (2000)	1889 (2009)	1820 (2008)	1888 (2009)	1960 (2010)
Rezoluta e parë e Këshillit të sigurimit që **lidh përvojat e grave me konfliktet dhe ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare.** Potencon **lidershipin** e grave dhe rolin e tyre në zgjidhjen e konflikteve, në bisedat për paqe dhe rimëkëmbje, kërkon përforcimin e reagimit me ndjeshmëri gjinore në misionet paqeruajtëse dhe trajnime për barazi gjinore për të gjithë të involvuarit në ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Prezantuar nga Namibia, 2000	Merret me **mospërfshirjen e grave në fazat fillestare të rimëkëmbjes dhe ndërtimit të paqes si dhe mungesës së planifikimit adekuat dhe financimit** për nevojat e tyre. Kërkon përpilimin e **strategjisë** për rritje të përfaqësimit të grave në procesin e vendimmarrjes për zgjidhje të konflikteve dhe kërkon krijim e **mjeteve** për përmirësimin e zbatimit të: **indikatorëve** dhe propozimeve për mekanizma monitorues. Prezantuar nga Vietnami, 2009	Rezoluta e parë e Këshillit të sigurimit e cila njeh **dhunën seksuale e ndërlidhur me konfliktin** si taktikë lufte dhe çështje problematike për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, që kërkon ndjeshmëri dhe përgjegjësshmëri në ruajtjen e paqes, drejtësi, shërbime dhe negociata për paqe. Prezantuar nga SHBA-të, 2008	Përforcon mënyrat/mjetet për zbatimin e rezolutës 1820 përmes emërimit të një **lidershipi të nivelit të lartë, ndërtimit të ekspertizës për** përgjegjësshmëri **juridike, përforcimit të shërbimeve, dhe ndërtimit të mekanizmave raportuese.** Prezantuar nga SHBA-të, 2009	Siguron sistemin e llogaridhënjes për adresimin e dhunës seksuale të ndërlidhur me konfliktet, përfshirë mënyrat e publikimit të emrave të keqbërësve dhe themelimit të mekanizmave për monitorim, analizë dhe raportim. Prezantuar nga SHBA-të, 2010

PERSONAT PËRGJEGJËS

1325 (2000)

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së duhet:

- Të rrisë **përfaqësimin** e grave në procesin vendimmarrës të OKB-së për paqe dhe siguri.
- Të sigurojë që gratë **do të marrin pjesë** në bisedimet për paqe.
- Të sigurojë informata mbi gratë dhe konfliktet në **raportet e shtetit në Këshillin e sigurimit.**

Shtetet duhet:

- Të sigurojnë trajnim për çështje gjinore dhe konflikte.
- Të përfshijnë çështjet gjinore në programet për çarmatim, demobilizim dhe riintegrim.

Palët e përfshira në konfliktet e armatosura duhet:

- Të **mbrojnë** gratë nga dhuna seksuale dhe e bazuar në gjini.
- Të respektojnë **karakterin civil** të refugjatëve dhe të personave të zhvendosur brenda territorit.
- Të **parandalojnë faljen** dhe të shmang amnistinë për krimet e luftës ndaj grave.

Këshilli i sigurimit duhet:

- Të merr parasysh ndikimin e veprimeve të veta mbi gratë dhe vajzat.
- Të zhvillojë takime me grupet e grave gjatë misioneve të veta.

1889 (2009)

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së duhet:

- Të përpilojë strategji për rritje të numrit të paqeruajtësve femra dhe femrave vendimmarrëse në radhët e paqeruajtësve .
- Të përpilojë **raport global** për pjesëmarrjen e grave në ndërtimin e paqes.
- Të mundësojë entitetet e OKB-së të grumbullojnë të **dhëna** për gjendjen e grave në fazat pas konfliktit.
- Të vendos kështilltarë për çështje gjinore dhe/ose **kështilltarë për mbrojtje të grave** në misionet paqeruajtëse.
- Të prodhojë një **sërë indikatorësh global për implementimin e rezolutës 1325.**
- Të propozojë Mekanizëm të kështillit për monitorim të rezolutës 1325.

Shtetet duhet:

- Të promovojnë **pjesëmarrjen** e grave në proceset vendimmarrëse politike dhe ekonomike në fazën e hershme të ndërtimit të paqes.
- **Të përcjellin shpenzimin e të hollave të planifikuara për** gratë pas konfliktit dhe në planifikimin e rimëkëmbjes, të investojnë në sigurinë fizike dhe ekonomike të grave, në shëndetësi, arsim, drejtësi dhe pjesëmarrje në politikë.

Këshilli i sigurimit duhet:

- Të shtojë provizione për **emancipim të grave në** ripërtëritjen e mandateve të misioneve të OKB-së.

Komisioni për ndërtim të paqes duhet:

- Të trajtojë çështjen e angazhimit të grave në ndërtimin e paqes.

1820 (2008)

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së duhet:

- Të sigurohet që dhuna seksuale do të trajtohet gjatë **zgjidhjes së konflikteve,** si dhe gjatë **përpjekjeve** për rimëkëmbje pas konfliktit.
- Të diskutojë çështjen e dhunës seksuale gjatë **dialogut** me palët e përfshira në konflikt të armatosur.
- Të sigurojë që **gratë** janë **përfaqësuar** në institucionet për ndërtim të paqes.
- Të sigurojë që dhuna seksuale është trajtuar në proceset e ndihmuara nga OKB-ja për Demobilizim, çarmatim dhe riintegrim, dhe në reformat e sektorëve juridik dhe të sigurisë.

Palët e përfshira në konfliktet e armatosura duhet:

- **Të ndalojnë dhunën seksuale,** të kenë përgjegjësi komanduese, dhe të mbrojnë civilët nga dhuna seksuale duke përfshirë hetimin e keqbërësve të dyshuar nga radhët e forcave të armatosura dhe duke evakuuar civilët në rrezik.
- Të ndalojnë në mënyrë kategorike **amnistinë** për dhunën seksuale si krim lufte.

Shtetet duhet:

- **Të ngrisin vetëdijen** dhe të ndërmarrin hapa për parandalim të dhunës seksuale duke angazhuar gratë në personeline paqeruajtësve.
- Të sigurojnë **trajnim** për parandalim të dhunës seksuale për trupat.
- Të zbatojnë politikë me **zero tolerancë** për aktet e abuzimin seksual të kryer nga paqeruajtësit e OKB-së.
- Të përpilojnë masa për përmirësim **të mbrojtjes dhe ndihmës,** veçanërisht në sistemet e drejtësisë dhe të shëndetësisë.

Këshilli i sigurimit duhet:

- Të trajtojë **shkaqet kryesore të dhunës seksuale** për të zhdukur mitet për pashmangshmërinë dhe pamundësinë për të parandaluar dhunën seksuale në luftë.
- Të përfshijë dhunën seksuale si kriter në **sanksionet** specifike për shtete të caktuara.

Komisioni për ndërtim të paqes duhet:

- Të këshillojë për mënyrat e trajtimit të dhunës seksuale.

1888 (2009)

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së duhet:

- Të emërojë përfaqësues special të sekretarit të përgjithshëm (PSSP) për qëndrimet e OKB-së në lidhje me dhunën seksuale gjatë konfliktit.
- **Të emërojë kështilltarë për mbrojtje të grave** në misionet paqeruajtëse të OKB-së në kontekst të nivelit të lartë të dhunës seksuale.
- **Të krijojë ekip** të ekspertëve juridik **për reagim të shpejtë.**
- Të sigurojë që **bisedat paqësore** trajtojnë dhunën seksuale.
- **Të emërojë më tepër gra si ndërmjetësuese.**
- Të propozojë mënyra në të cilat Këshilli i sigurimit mund të përmirësojë **monitorimin** dhe raportimin për dhunë seksuale të ndërlidhur me konflikt.
- Të përmirësojë **të dhënat** mbi trendët dhe format e dhunës seksuale.
- Të sigurojë detaje për Këshillin e sigurimit për pjesëtarët e palëve të përfshira në konflikt të armatosur për të cilët ekziston bazë për të dyshuar se kanë kryer forma të përdhunimit.

Aksioni i OKB-së kundër dhunës seksuale në konflikt (rrjet i përbërë prej 13 organe të OKB-së) duhet:

- Të ketë kohezion në reagimin e OKB-së.

Shtetet duhet:

- **Të përmirësojnë kornizat nacionale ligjore** dhe sistemet juridike për të parandaluar faljen.
- Të përmirësojnë **shërbimet përkrahëse për viktimat e dhunës seksuale.**
- Të sigurojnë që **liderët tradicional** do të parandalojnë stigmatizimin e viktimave.
- Të përkrahin strategji gjithëpërfshirëse nacionale/të OKB-së për të **ndaluar dhunën seksuale.**

Këshilli i sigurimit duhet:

- Të ngris dhunën seksuale si akt të veçant në komisionet saksionuese

1960 (2010)

Sekretari i përgjithshëm i OKB-së duhet:

- Të përfshijë në Axhendën e Këshillit në një shtojcë të raporteve vjetore **palët për të cilat ekziston bazë për të dyshuar se kanë kryer apo janë përgjegjëse për dhunë seksuale** në situata.
- Të themelojë mekanizëm për **monitorim, analizë, dhe raportim** për dhunën seksuale të ndërlidhur me konflikt.
- Të dorëzojë raporte **vjetore** – përfshirë plan strategjik dhe të koordinuar për grumbullim etik dhe në kohë të duhur të informatave.

SPPS duhet:

- Të sigurojë **informata** për Këshillin.
- Të informojë **Komitetet për sanksione dhe grupet e ekspertëve.**

Shtetet duhet:

- Të zhvillojnë **dialog** me palët e përfshira në konflikt të armatosur që të sigurohen përgjegjësitë për mbrojtje.
- Të sigurhet që i gjithë personeli ushtarak dhe policor i angazhuar në operacionet paqeruajtëse të ndjek trajnimet adekuate për dhunë seksuale dhe dhunë në bazë gjinore, shfrytëzimin seksual dhe keqatrajtim.
- Të angazhojnë më shumë gra në personal **të ushtrisë dhe policisë** në operacionet paqësore.

Palët e konfliktit të armatosur duhet:

- Të zbatojnë **veprime** specifike dhe në afat të caktuar **kundër dhunës seksuale**, që mes tjerash duhet përfshirë lëshimin e urdhrave të qarta në zingjirin komandues që ndalojnë dhunën seksuale, ndalimin e dhunës seksuale në Kode të mirësjelljes, në doracak ushtarak apo dok. ekuivalente, dhe të bëjnë hetime në kohë të duhur për pretendime për abuzime me qëllim që të mbajë përgjegjës keqbërësit.

Këshilli i sigurimit duhet:

- Të sigurojë që dhuna seksuale të merret parasysh kohë pas kohe në autorizimin **dhe ripërtëritjen e mandateve.**
- Të merr parasysh **përdorimin e sanksioneve** kundër palëve.

PIKA PËRGJEGJËSE / LIDERSHIPI PËRGJEGJËS BRENDA OKB-SË

UN Women është ka rol udhëheqës në sigurimin e koherencës dhe koordinimit në përgatitjen e programeve për gra dhe vajza në lidhje me paqen dhe sigurinë (Deklaratë e presidencës S/PRST/2010/22).

Raporti i 2010 nga SP për **Pjesëmarrjen e grave në ndërtimin e paqes** (S/2010/466) definon plan 7-pikësh për ndërtim të paqes duke marr parasysh aspektin gjinor. Koordinatorë janë **Zyra për përkrahje të ndërtimit të paqes** dhe **UN Women.**

Njësia për përvojat më të mira të **Departamentit të operacioneve paqeruajtëse** përpiloi rezolutën 1820 + 1 raport në 2009.

Aksioni i OKB-së kundër dhunës seksuale në konflikt (rrjet i përbërë prej 13 organeve të OKB-së) përkrah koordinimin.

PSSP të ndërtojë koherencë dhe koordinim në reagimin e OKB-së nga dhunës seksuale në konflikt.

Të lidhet me **Aksionin e OKB-së kundër dhunës seksuale në konflikt** për koordinim.

Zyra e **PSSP-së për dhunë seksuale në konflikt**, me mbështetjen e **Aksionit të OKB-së kundër dhunës seksuale në konflikt.**

MEKANIZËM PËR MONITORIM DHE RAPORTIM

Korniza strategjike e OKB-së për gratë dhe paqen dhe sigurinë 2011-2020.

Shqyrtim joformal: debat të hapur çdo tetor, dhe takime joformale të Këshillit mbi këtë temë. Informim periodik të Këshillit nga nënsekretari i përgjithshëm, UN Women.

Indikatorët global për rezolutën 1325 janë bazë për monitorim. Indikatorët prezantohen në Raportin e Sekretarit të përgjithshëm për Këshillin (S/2010/498).

Raport vjetor (por pa parametra të qarta për monitorim dhe raportim).

Shqyrtim mujor nga grupi i ekspertëve për mbrojtje të civilëve pranë Këshillit të sigurimit [i informuar nga *Zyra për koordinim të çështjeve humanitare*]

Fton për përpilimin e propozimeve për mekanizma monitorues dhe raportues.

Raport vjetor për të siguruar detaje rreth dukurive dhe keqbërësve.

Kërkon që Sekretari i përgjithshëm të organizojë **monitorim, analizë dhe raportim** për dhunë seksuale në konflikt, përfshirë përdhunimet në gjendje të konfliktit të armatosur, në fazat pas konflikteve dhe situata tjera me interes [OP 8].

MEKANIZËM PËR PËRGJEGJËSI
(pasoja për shkelje të rezolutës)

Nuk ekzistojnë. Asnjë referencë për sanksione ndaj keqbërësve.

Tentativë për amnisti—palët ftojnë që të shmanget dhënia e amnistisë për krime lufte ndaj grave "aty ku është e mundur" [OP 11].

Nuk ekzistojnë—por në vitin 2010 fton në rekomandime për mënyrën se si Këshilli do të pranojë, analizojë dhe veprojë në lidhje me informatën për 1325 [OP 18].

Dhunë seksuale relevante për **sanksione** specifike për vende të caktuara [OP 5].

SP të përpilojë **strategji për trajtim të dhunës seksuale në dialog** me palët e përfshira në konflikt të armatosur [OP 3].

Përjashtim kategorik të krimeve të dhunës seksuale nga dispozitat për **amnisti** [OP 4].

Komiteteti për **sanksione** duhet të shtojë kritere që kanë të bëjnë me aktet e përdhunimit dhe formave tjera të dhunës seksuale [OP 10].

Liderët nacional dhe lokal, përfshirë autoritetet tradicionale/fetare, të luftojnë margjinalizimin dhe njollosjen e viktimave [OP 15].

Kërkesë për **përkushtime me afat të caktuar** për ti dhënë fund dhunës seksuale nga ana e palëve në konflikt dhe përfshirjen e dhunës seksuale në kriteret të shqyrtuara nga komitetet për sanksion [OP 3, 5, 7].

Raportet **ku bëhen publik keqbërësit** të shqyrtohen në Këshill [OP 18].

BURIME

www.unwomen.org/1325plus10

www.stoprapenow.org

PHOTO: UN PHOTO / ERICKANALSTEIN

PHOTO: UN PHOTO / RICK BAJORNAS

PHOTO: UN PHOTO / MARTINE PERRET

PHOTO: UN PHOTO / MARCO DORMINO

PHOTO: UN PHOTO / AGNIESZKA MIKULSKA

PHOTO: PERSONAL COLLECTION / ANONYMOUS

PHOTO: UN PHOTO / MARTINE PERRET

UN WOMEN

United Nations Entity for Gender Equality and the Empowerment of Women